Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

I. Punime Shpyllezimi ,prishje e Transporti

-Prerje bime te vogla $\varnothing \sim 10\text{cm}$

-Prerje e sistemim pemesh $\varnothing 10 \sim 20 \text{ cm}$

-Shkulje rrenjeve bimeve te vogla

Pastrime shkuresh e prerje pemesh

Pastrimet te ralizohen me krahe ose me makineri prerese. Pemet me motoshare, ne

Permase deri 2m dhe largohen nga sheshi

Ndalohet kategorikisht azgjesimi i shkureve dhe pemeve me anen e djegjes.

-Prishje strukturash betoni (Prishje shtresa betoni, mure betoni)

Ne kete ze pune jane parashikuar prishja e strukturave te betonit ,si themele mure

rrethues si dhe mure betoni , shtresa betoni e bordurash , shtresa e pllakave ekzistuese te trotuarit si dhe ne permirsimin e kalimit.Ky ze pune do te matet ne fakt ne m3.

II. GERMIMET

Perpara fillimit te ndonje germimi, Kontraktori do te takoje ofruesit lokale (per energjine, komunikimin, etj) per te lokalizuar kabllot ekzistuese dhe tubat. Çdo instruksion i dhene nga keto ndermarrje do te ndiqet. Per te identifikuar vendin e tubave ekzistuese dhe kabllot, Kontraktori do te siguroje germime te zakonshme te kanaleve shtese. Atje ku kabllot dhe tubat ekzistuese nderpresin kanalin ose ecin paralel, Kontraktori duhet te germoje me krah. Per te gjithë kohen e ndertimit, kabllot dhe tubat ekzistuese duhet te sigurohen dhe mbeshteten. Kabllot, kokat e tyre dhe tubat qe jane paralel ne kanalin e tubave do te mbeshteten ne menyre te sigurt. Kabllot e mundshme ekzistuese mund te hiqen perkohesisht ne se lejohet dhe te vendosen ne kantier. Pas perfundimit te puneve, kabllot dhe tubat duhet te rivendosen dhe te shenohen me nje shirit kablli per kujdes. Kontraktori do te lejohet te perdore eksploziv vetem me lejen e Inxhinierit dhe Punedhenesit. Pas gjetjes se lejes se dhene, te gjitha shperthimet do te behen nga persona te trainuar dhe te kualifikuar nen supervizimin e nje drejtuesi me experience i cili ka nje certificate zyrtare autentike per shperthimet. Kostot per sigurimin, heqjen dhe rivendosjen e linjave ekzistuese te sherbimit do te perfshihen ne cmim njesi. Kanalet dhe gropat e pusetave do te germohen sipas standarteve (i.e. DIN 4124, DIN EN 1610). Kanali i tubave do te jete sipas profilit. Gjeresia e pjeses se poshtme e kanalit do te jete sipas DIN EN 1610 per diametrin nominal te tubit. Thellesia e kanalit dhe e pusetave do te jepet ne vizatime.

X i korrespondon hapesires minimale ndermjet tubave dhe mureve te kanalit
Dj – Diametri i jashtem i tubit i dhene ne m - kendi i pjerresise se mureve te kanalit i matur nga horizontali

Dherat e germuar (klasa 3-4), ne se eshte e mundur te magazinohen ne anen tjeter te kanalit ne sasine qe kerkohet per rimbushje te kanaleve. Dherat e germuar qe nuk mund

te vendosen ne ane te kanalit duhet te transportohen ne nje vend tjeter te siguruar nga Kontraktori dhe do te perdoren per rimbushje te kanalit te tubave. Kontraktori do te parashikojë ndonje vend magazinimi te dherave per te lejuar transportin e tyre ne distance te gjate dhe pa demtim te tubave. Kontraktori duhet te parashikojë te germoje dherat e klases 6-7 me çekiç pneumatik sipas standarteve dhe kushteve teknike mbi sigurine e punimeve. Kontraktorit duhet te marre aprovimin e Inxhinierit per germimet speciale te dherave te klases 6-7. Gjithashtu, dherat e klases 3-5 mund te germohen me metoda manuale dhe ose makineri. Kontraktori duhet te marre aprovimin e Inxhinierit per perdorimin e çdo metode dhe ai duhet te kete nje protokoll, perfshi librin e masave me volume dhe dimensionet e kanalit per çdo prej tyre. Guret dhe materialet me te medha se 25 cm do te mblidhen dhe largohen me shpenzimet e Kontraktorit. Kontraktori do te largoje dherat e hequra me shpenzimet e veta. Pergatitjet per nenshtresat (shtrati i tubave) ne pjesen e poshtme te kanalit do te devijojne deri ne jo me shume se 2 cm nga thellesia e kerkuar e germimit. Te gjitha punet shtese te lidhjeve te tubave dhe germimet e pusetave do te perfshihen ne çmimin njesi.

Kanalet e germuar mund te hapen deri ne distance 50 m. Kanalet duhet te rimbushen pas instalimit te tubave dhe pjeseve lidhese te tyre brenda dites se punes. Kontraktori do te jete pergjegjes per çdo demtim te kanaleve te hapur gjate diteve te shiut dhe qe nuk ka permbushur kushtet e mesiperme.

Gjate germimit te kanaleve, Kontraktori do te perdore mbeshetese ne te dy anet e kanalit duke filluar nga fundi kanalit ne te gjithe thellesine qe jane me shume se 0,9 m (perveç se kur eshte shkemb ose dhe i forte).

III. Punime Shtresash

SHTRATI I TUBAVE

Per nje themel uniform te tubave, Kontraktori duhet te siguroje nje shtrese rere ose zhavorri (madhesia maksimale e kokrrizës: 20 mm) sipas DIN EN 1610 me nje trashesi 100 mm + 1/10 DN ne mm. Shkalla e ngjeshjes kerkohet te jete 97 %. Kontraktori do te zbatoje testet (testi: plate load test sipas DIN 18134) per te verifikuar shkallen e ngjeshjes.

- SHTRATI I ZHAVORRIT

Perpara ndertimit te pusetave, Kontraktori do te instaloje nje shtrese zhavorri me

trashesi 10-20 cm. Nje shkalle ngjeshje prej 95 % eshte e kerkuar. Kontraktori duhe te beje edhe testet perkatese (testi: plate load test sipas DIN 18134) per te verifikuar shkallen e ngjeshjes.

- MBUSHJE FILLESTARE

Kontraktori duhet te mbushe kanalin me dhe te skrifet te zgjedhur nga germimi, kjo shtrese do te jete deri ne 20 cm) duke perdorur nje ngjeshje manual ose ngjeshje te vogel. Nje shkalle ngjeshje

prej 95 % eshte e kerkuar. Kontraktori duhe te beje edhe testet perkatese (testi: plate load test sipas DIN 18134) per te verifikuar shkallen e ngjeshjes.

- MBUSHJA E PUSSETAVE

Pas ndertimit te pusetave, Kontraktori duhet te mbushe gropen e germuar me dhe te ngjeshur jo - kohesive, (klasa 3-4, koeficient: $U = 6 - 10$, permbajtje argjil/ dhe(madhesi kokrrize $= 0.06 \text{ mm}$): max. 10%) i lire nga mbetjet, materiale te keqia apo bimesi. Mbushja do te zbatohet ne shtresa 40 cm per secilen.

Cdo shtrese do te ngjeshet nga nje ngjeshes i aprovuar perpara vendosjes se cdo shtrese. Nje shkalle ngjeshje prej 95 % eshte kerkuar. Kontraktori duhet te zbatoje testet (testi: sipas DIN 18134) per te verifikuar shkallen e ngjeshjes.

- DERRASAT PER KALIMIN E KANALEVE

Gjate ndertimit te kanalave, Kontraktori do te siguroje dhe mirembaje disa derrasa per kalimin e sigurt te kanaleve me nje ndertim te qendrueshem. Keto derrasa te levizshme per kalimin e kanaleve do te kene edhe mbrojtese te thjeshta. Nje Instruksion i Inxhinierit apo Punedhenesit per keto kalime duhet te behet.

- SIGURIMI I RRETHIMEVE DHE MUREVE EKZISTUESE

Gjate punes se ndertimit, rrethime dhe mure ekzistuese duhet te mbeshteten dhe te sigurohen. Cdo lloj i themeleve qe eshte i ekspozuar gjate punimeve te tokes dhe ka nje risk per te rene, duhet te sigurohet dhe mbeshtetet sipas zgjedhjes se Kontraktorit duke perfshire edhe punet shtese.

- SIGURIMI I POSTEVE DHE SINJALEVE EKZISTUESE TE NDRICIMIT

Postet e ndricimit, treguesit dhe shenajt e trafikut qe jane vendosur ne zones e trasese dhe kane problem per qendrueshmerine e tyre gjate periudhes se ndertimit do te mbeshteten dhe sigurohen me kujdes kundrejt kolapsit dhe paqendrueshmerise.

- HEQJA E UJIT

Kontraktori duhet të sigurojë heqjen e ujit nga kanali i tubave dhe pusetave duke përfshirë pompa, gjeneratore e pajisje për heqjen e ujit (pompa, tuba) dhe pajisje të tjera.

Aty do të

përfshihet mirëmbajtja, operimi, kontrolli dhe shërbimi i impiantit për të gjithë periudhën e ndërtimit. Nëse kërkohej, leja për shkarkimin e ujit të ujërave të shiut dhe sistemet e ujërave të zeza apo të lumit nëse ka.

IV. Ndërtimi i Veprave të Artit+Kanalizime

Vendosja e tubove.

Para se të vendoset tubi I BETONIT $d=1500\text{mm}$ në kanal, në bazën e tij duhet të hidhet 20cm shtresë uniforme zhavorr i imët. dhe duhet të ngjeshet sipas ktz.

Mbi këtë shtresë vendoset tubi I betonit $D=1500\text{mm}$.

Për tubat e brinjëzuar ka një strukturë tjetër hidhet 10cm shtresë uniforme me rërë të imët e cila cilindrohet me pllake vibruese.

Mbi këtë shtresë vendoset tubi I brinjëzua $D=400\text{mm}; 600\text{mm}$.

Niveli i çdo tubi do të përcaktohet gjithmonë me instrument topografik.

Ky proces është i domosdoshëm për të garantuar vetërrjedhjen, shpejtësinë dhe prurjen e llogaritur në projekt. Më pas kanali mbushet

përsëri me rërë të imët deri 10cm mbi pjesën e sipërme të tubit. Pas këtij procesi

hidhen dhe i shkrifet. Çdo shtresë duhet të ngjishet me rul.

Kompaktesimi i shtresave (gjatë mbulimit të tubit) do të kryhet me tokmak elektrik

(çdo 30cm), duke eliminuar goditjen direkte mbi tub në 30cm e përreft. Mbushja e

kanalit dhe gjendja e mirë teknike e tij do të quhet e rregullt pasi të rezultojë me

sukses prova e penetrimit (me ngarkesë goditëse 3Kg) si dhe prova e

qëndrueshmërisë. Tubat lidhen njëri pas tjetrit me duke u futurë gotë me gotë. Lidhja duhet të jetë në përshtatje me standartin dhe të rezistojë presionit 0,5 bar.

Tubat gjatë transportit, shtrirjes dhe lidhjes nuk duhet të pësojnë deformime ose çarje.

Gjatë vendosjes së tubacioneve duhet të kryhen matje

topografike për të garantuar pjerrësitë e përcaktuara në projekt.

Materialet mbushese nuk duhet te kene gure ose ndonje material tjeter te forte qe ka dimensione 150 mm, ne asnje drejtim.

Kanalet ne siperfaqe do te jene te risistemuar me materiale te njejta si siperfaqja origjinale e shtruar pasi Inxhinieri ka rene dakort qe instalimi eshte kompletuar. Anet e risistemimit do te priten ne vija te drejta para se te jepet dora e fundit e rregullimit.

Atje ku eshte e mundur, do te perdoren materialet e zgjedhura nga germimi, dhe te hiqen guret me madhesi mbi (>35mm) ose ndonje objekt tjeter i forte.

Te gjithë materialet do te vendoset dhe do te ngjeshen me dore ose me ngjeshes mekanik te pershtatshem; kg/m³.

Fundi i kanalit duhet te jete i qendrueshem.

Muri i brendshem duhet te jete me sip te lemuar I vibruar ne menyre perfekte.

Gjatesia e tubove duhet te jete 1.0 ml,por mund te jete edhe 2ml sipas prodhimit

Tubat që do të përdoren duhet të jenë të pajisura me çertifikatat përkatëse që vërtetojnë cilësinë e tyre me nje nga labororet e licensuar shteteror.

Pusetat e kontrollit b/a

Do të realizohen prej betoni të armuar. Ato do te realizohen me beton të armuar me suport dhe kapak gize me diametër 60cm.

Lartësia e pusëtës llogaritet duke mbetur kapaku I gizës në nivelin e sipërfaqes përfundimtare të shtresave të rrugës ose trotuarit

Te gjitha punimet e betonit qe do te kryhen per strukturat e pusetave, do te projektohen dhe ndertohen ne perputhje me standartet shqiptare.

Shufrat e armimit duhet te ruhen dhe duhet te mbrohen me materiale kunder ndryshkut, demtimeve, vajit ose agjenteve te tjere shkaterrues.

Kontraktori do te jete pergjegjes per kontrollin e te gjithë shufrave te kerkuars nga Inxhinieri dhe te jape garanci per saktesine para prerjes dhe lidhjes se hekurit te armuar.

Perzjerresit do te perdoren vetem me nje aprovim me shkrim te Supervizorit, me qellim qe te modifikohen karakteristikat e betonit dhe te arrihen rezultatet

Markat e betonit te perdorura ne Punime do te jene sipas kerkeses ose me keshillat e Supervizionit.

Kallepet

Te gjithë skeletet, kallepet, mbeshtetësit, dhe vend kalimet do te jene te nje cilesie te pershtateshme dhe me te tille fortesi qe te jane perseri rigjide pa lene ndonje shtremberim ose ndryshim gjate gjithë formes gjate vibrimit dhe ngjeshjes se betonit. Drure ose derrasa me nje trashesi me te vogel se 20 mm nuk do te perdoren pa nje aprovim specifik te Investotorit. Te gjithë lidhjet e kallepeve duhet te jene me mbyllje te pershtateshme per te shmangur humbjen e materialeve te imta ose te llacit gjate hedhjes dhe konsolidimit te betonit. Forma e kallepit duhet te jete e projektuar e tille qe te mund te lejoje levizjen e tij pa demtuar betonin.

Kontraktori do te duhet te jape nje njoftim Investotorit 24 ore me pare per te hequr cdo kallep. Pasi betoni eshte formuar, kallepet duhet te hiqen me shume kujdes, pa goditje ose ndonje prishje, ne menyre qe betoni te mos te demtohet. Asnje kallep nuk duhet te hiqet para se betoni te jete formuar plotesisht per te shmangur cdo prishje te struktures se betonit.

Ne pergjithesi, betoni do te konsolidohet me vibratore elektrik ose pneumatik.

Vibrimi i cili shkakton ndarje te perberesve ose nje siperfaqe te ujezuar, ose e cila sjell nje sasi te madhe te njomjes ne siperfaqe duhet te shmanget.

Për të gjithë llojet e pusetave bazamenti dhe kapaku prej gize duhet të jenë sipas standartit shqiptar.

Për të gjitha pusetat e kontrollit, per kapaket, rekomandohet tipi me ventilim, me menteshe, me diametër të jashtë 610mm dhe lartësi 100mm.

Kapakët do të vendosen në nivelin dhe pjerrësinë përfundimtare të sipërfaqes së rrugës ose trotuarit.

Nuk duhet të kryhen ndryshime të projektit gjatë zbatimit të tij. Në rastet kur është e domosdoshme duhet që këto të miratohen me shkrim nga klienti dhe supervizori i punimeve.

Standardet (Referencat)

Standardet e referencës janë ato shqiptare dhe standardet e vendeve të Bashkimit

Europian EEC që konsiderohen si ekuivalente.

Sidoqoftë Sipërmarrësi për standardet që ai mendon të përdorë duhet më parë të bjerë dakord me Investitorit përpara fillimit të punimeve.

Materialet dhe pajisjet do të jenë sipas standarteve kombëtare ose ndërkombëtare të aprovuara.

Të gjitha materialet dhe komponentet përberëse do të jenë të certifikuar sipas standarteve Shqiptare dhe të gjitha prodhimet do të jenë konform Standarteve

Kombëtare të ngjashme ose Kodet Praktike. Kontraktori mund të propozojë standarte alternative kombëtare të alternativave të propozuara të cilat duhet t'i paraqiten

Supervizorit për rishikim dhe aprovim. Një kopje e të gjithë standarteve të aprovuara do të mbahen në Kantier nga Kontraktori. Neqoftese nuk ka Specifikime të

Standarteve të publikuara, materialet dhe prodhimet do të jenë nga standartet me të

mira të përshtatshme dhe do të jenë subjekt për aprovim nga Supervizioni. Kur punimet e propozuara lidhen me rrjetet ekzistuese materialet e reja do të jenë të përshtatshme me ato ekzistueset.

Transport, Ruajtja dhe magazinimi

Transporti i tubave të betonit D=1500 do të kryhet nga furnizuesi i tubave të FSHZH-se

Transporti i tubave të brinjëzuar D=400mm dhe D=600mm të siguruar nga FSHZH-ja do të kryhet nga Kontraktori pasi janë të depozituar pranë UKK-sha dhe në analize teknike të vendosjes së tubave të brinjëzuar është parashikuar transport mesatarë rreth 5km

Të gjitha materialet do të jenë të mbrojtura mjaftueshëm me mënyra të aprovuara për të gjithë periudhën e tranzitit, magazinimit, si dhe të eliminohen dëmtime aksidentale.

Kontraktori do të jetë përgjegjës për mbrojtjen në mënyrë që materialet të arrijnë në vend të pa dëmtuara. Shkarkimi do të bëhet nga kontraktori (për shkarkimin e materialeve të furnizuara në vend ose magazine) dhe ai është përgjegjës për ndonjë dëmtim.

Magazinimi në vend dhe mbajtja duhet të realizohen në mënyrë sa më të sigurtë të

jete e mundur, dhe materialet që do të magazinohen të hapura në vend të mos

demtohen .

Ngarkimi dhe shkarkimi do te behen ngadale me paisje te pershtatshme dhe tubacioni duhet te jete nen kontroll gjate gjithe kohes. Ne asnje rast nuk duhet qe tubacioni te perplaset ose te hidhet nga lartesite. Ne cdo rast duhet te perdoren rekomandimet e prodhuesit te tubave.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

PREVENTIV

Objekti:Germim dheu , shtrim linje kun-je e Puseta b/a me tuba betoni D=1500mm e te brinjezuar D=400&600mm

Adresa: Rruga Nene Tereza Laknas dhe kolektor i rruges Lekaj Bathore lgj.4

NR.	An.	EMERTIMI	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
A		LINJE KUN-je Rruga Nene Tereza tuba Betoni D=1500mm				
I		Punime Shpyllezimi ,prishje e Transporti				
1	3.2	Prerje bime te vogla ø ~ 10cm	m ²	10,620		
2	3.3	Prerje e sistemim pemesh ø 10 ~ 20 cm	copë	420		
3	2.426/5	Prishje mure betoni	m ³	10		
4	3.158/5a	Transport materiale te ndryshme (bime ,ferra,peme etj)me auto deri 5.0 km	m ³	1,060		
SHUMA I						
II		Punime Germimi+mbushje				
1	3.107/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 1.0 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke	m ³	2,326		
2	3.715	Mbushje, rafshim me zhavorr lumi +pjese e dheut te shkrifet te germuar)	m ³	1,200		
SHUMA II						
III		Punime Shtresash				
1	3.198	Cilindrim kasonete me rul ose pllake vibruese	m2	4,071		

2	3.205/2	Shtrese zhavor lumi t=20cm, me cilindrim poshte Tuba bet. D=1500mm	m2	4,071		
SHUMA III						
IV		Ndertimi i Veprave te Artit+Kanalizime				
1	3.369/-an	Shtrim linje Tombino me tuba betoni Ø 1500 (perfshihet vetem vendosja)	ml	1,770		
2	3.584-an	Ndertim Pusete kontrolli b/a. 2x2.5xH=3m me kapak gize Klasi:D400 - max 40 ton	cope	14		
3	2.262/4	Shtrese betoni C16/20 (Mbeshtjellje e bashkimit te tubave te vjeter me te ri)	m³	9		
4	2.262/4	Shtrese betoni C16/20 shtroja tek Muri B/A pk 68-69	m³	2		
5	2.207	Mur betoni C 16/20 Pk.68-69 pjesa e shkarkimit ne Lume	m³	10.5		
6	2.166/1a	F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm per murin	Ton	0.20		
SHUMA IV						
SHUMA(I+II+III+IV) e A						
B		LINJE KUN-je Rruga Nene Tereza tuba Brinjezuar D=400&600mm				
I		Punime Shpyllezimi ,prishje e Transporti e heqje uji I ndotur				
1	3.2	Prerje bime te vogla ø ~ 10cm	m²	3,440		
2	3.3	Prerje e sistemim pemesh ø 10 ~ 20 cm	copë	120		
3	2.426/5	Prishje mure betoni	m³	2		
4	3.158/5a	Transport materiale te ndryshme (bime ,ferra,peme etj)me auto deri 5.0 km	m³	200		
SHUMA I						
II		Punime Germimi+mbushje				
1	3.101/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke	m³	1,966		
2	3.715	Mbushje, rafshim me zhavorr lumi +pjesa e dheut te shkrifet te germuar)	m³	756		
SHUMA II						
III		Ndertimi i Veprave te Artit+Kanalizime				
1	3.164/4t/-an	Shtrim linje tuba Brinjezuar D=600mm (perfshihet vendosja+shtrese rere e mbushje me rere sipas projektit +transport tuba 5km)	ml	1,805		
2	3.164/2t	Shtrim linje tuba Brinjezuar D=400mm (perfshihet vendosja+shtrese rere e mbushje me rere sipas projektit +transport tuba 5km)	ml	120		
3	2.523/1	F.V Tuba PVC f=200 mm te brinjezuar	ml	60		

4	2.599	F.V. pusete shkarkimi 100x100, h=150, me kapak gize	cope	22		
5	2.262/4	Shtrese betoni C16/20 (Mbeshtjellje e tubave te familjareve)	m³	2		
					SHUMA III	
SHUMA(I+II+III) e B						
C		LINJE KUN-je Rruga Lekaj ,Bathore 4 tuba Brinjezuar D=600mm				
I		Punime Shpyllezimi ,prishje e Transporti e heqje uji I ndotur				
1	3.2	Prerje bime te vogla ø ~ 10cm	m²	2,544		
2	3.3	Prerje e sistemim pemesh ø 10 ~ 20 cm	copë	160		
3	2.426/5	Prishje mure betoni	m³	2		
4	An	Heqje uji me pompe Zhytese per Ujra te ndotur 1500 W me dalje≥2polsh	ore	200		
5	3.158/5a	Transport materiale te ndryshme (bime ,ferra,peme etj)me auto deri 5.0 km	m³	250		
SHUMA I						
II		Punime Germimi+mbushje				
1	3.102/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji ~1m, kategoria IV, me shk ne toke	m³	372		
2	3.715	Mbushje, rafshim me zhavorr lumi +pjesë e dheut te shkrifet te germuar)	m³	850		
SHUMA II						
III		Punime Shtresash				
1	3.198	Cilindrim kasonete me rul	m2	508		
2	3.205/2	Shtrese zhavor lumi t=20cm, me cilindrim poshte tubave te Brinjezuar D=600mm ne Kolektorin e Rr. Lekaj	m2	508		
SHUMA III						
IV		Ndertimi i Veprave te Artit+Kanalizime				
1	3.164/4t/-an	Shtrim linje tuba Brinjezuar D=600mm (perfshihet vendosja+shtrese rere e mbushje me rere sipas projektit +transport tuba 5km)	ml	630		
2	2.523/1	F.V Tuba PVC f=200 mm te brinjezuar	ml	40		
3	2.599	F.V. pusete shkarkimi 100x100, h=150, me kapak gize	cope	14		
4	2.262/4	Shtrese betoni C16/20 (Mbeshtjellje e tubave te familjareve)	m³	1		
SHUMA IV						

SHUMA(I+II+III+IV) e C	
SHUMA A+B+C	
TVSH 20%	
SHUMA TOTALE E OBJEKTIT	

Shenim: Tubat e betonit D=1500mm dhe te brinjezuar D=400mm dhe D=600 jane siguruar nga FSHZH-ja .

Transport dheu nuk do te kete pasi do te sherbej per mbushjen e kolektorit pas shtrimit te tubacionit.

Afatet e lëvrimit: 3 muaj ose 90 dite nga momenti i lidhjes se kontrates

NR.	EMERTIMI	30dite	30dite	30dite
	Kun-je Rr Argjinatura shkarkim lumi i Terkuzes			
1	Punime Shpyllezimi ,prishje e Transporti			
2	Punime Germimi			
3	Punime Shtresash			
4	Ndertimi i Veprave te Artit+Kanalizime			

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përfshirë nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2024** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;

- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

Ne rast se punimet jane kryer me sektorin privat:

- b)** Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim;
 - Fatura tatimore perkatese.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar).

Gjithashtu është kërkuar në DST:

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.



2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve huridike që ushtrojnë veprimtari

ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
 - **Kategoria NP-1 A** (*Punime gërmimi në tokë*)
 - **Kategoria NP-7** (*Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje*)
 - **Kategoria NP-12** (*Punime të inxhinierisë së mjedisit*)
- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
 - **Kategoria NS-18 A** (*Punime topogjeodezike*)

* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i liçensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Liçensat profesionale duhet t’i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Liçensa Profesionale.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001** (*Për sistemin e menaxhimit të cilësisë*) e përditësuar
- **ISO 14001** (*Për sistemin e menaxhimit të mjedisit*) e përditësuar
- **ISO 45001** (*Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose **ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare**, e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, ISO-t duhen plotësuar nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë liçencën – Kodi III.2.B - “Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL), të vlefshme.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **60 (Gjashtëdhjetë) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 9 në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni **2 (dy) Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Topograf**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Mjedisi**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit* duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.6 pika c, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

c) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi **38 (tridhjetë e tetë) punonjës** të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Teknik ndërtimi - jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Teknik Gjeometer– jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Hidraulik- jo më pak se **4(kater)** punonjës
- Hekurkthyes – jo më pak se **3 (tre)** punonjës
- Karpentier – jo më pak se **4 (kater)** punonjës
- Specialist Ndertimi – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Betonues – jo më pak se **3 (tre)** punonjës
- Punonjes manovrator automakinst– jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Punonjes manovrator buldozerist– jo më pak se **1 (nje)** punonjës
- Punonjes manovrator eskavatorist– jo më pak se **3 (tre)** punonjës
- Drejtues mjete shofer – jo më pak se **4 (kater)** punonjës

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1.				
2.				
etj.				

* Disponimi i stafit/ punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme, dëshmi/ certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.5.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

-
- d) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (ne rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) inxhinier që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10 237 date 18.02.2010 **“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”** dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 **“Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”** i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune, dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj.
 - Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) **specialist ekspert zjarrëfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.5, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë përkatëse të lëshuar nga Drejtoria MZSH/ekuivalente.
 - Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) punonjësi që përmbush kriteret për të qenë **“Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”**, i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë përkatëse.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 9, **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”**. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

2.3.6 (Makineri, Pajisje)

a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë,** automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

b)

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
3	Kamion me Vinc 5-7 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Rimorkiator për transport mjetesh të rënda min 20 ton + Koke Terheqese	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobetoniere kantieri 2.5-3.5 m ³ (mjet teknologjik)	në pronësi ose me qira	Copë 3
6	MiniDumper kantieri deri ne 5 m ³ (mjet teknologjik)	në pronësi ose me qira	Copë 2
7	Fadrome me Goma (mjet teknologjik)	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Eskavator me goma (mjet teknologjik)	në pronësi ose me qira	Copë 3
9	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
10	Vinc Eskavator mbi 60 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Makineri per shkulje pemesh pa i demtuar	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Rrul cilinder cilinder min 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Nofull hidraulike per prishje strukturash b/a	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Makineri teknologjike thithese per pastrimin e mbetjeve kapaciteti 7-9 m3.	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Betoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
17	Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
18	Tokmak ngjeshes	në pronësi ose me qira	Copë 2
19	Tranxhe per prerje hekuri	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Bango per kthim hekuri	në pronësi ose me qira	Copë 1
21	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 2
22	GPS	në pronësi ose me qira	Copë 1
23	Motomjet ose agregat per prerjen e bimesise	në pronësi ose me qira	Copë 2

24	Çekiç pneumatik	në pronësi ose me qira	Copë 1
25	Motogjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1

- c) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes
- d) në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:
- Kokore – *jo më pak se 30 copë*
 - Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 3 copë*
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo më pak se 5 copë*
 - Jelek fosforeshent – *jo më pak se 30 cope*

Makineritë dhe paisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje e noteruar.

